



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Uprava za Opštu Administraciju  
Directory of General Administration



## Plani i punës për Barazi Gjinore për vitin 2026

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Vetëdijësimi në çështjen e barazisë gjinore, mbajtja e ligjeratave, fushatave sensibilizuese në vise rurale dhe në qytet, zbatimi i rregullores për barazi gjinore, takime përgatitore me gratë e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioriteteve të grave me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjinore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të komunës, përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjinore, zbatimi, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre - janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2026 në kuadër të ZBGJ-së.

Në kuadër të këtij dokumenti të qeverisjes së Rahovecit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të drejtorive komunale.

Secila drejtori është përgjegjëse që në harmoni me objektivat strategjike të qeverisjes së komunës së Rahovecit të përcaktoj planin e vet të punës dhe ta realizoj të njëjtin, çdoherë duke qenë në shërbim të qytetarëve.

Më poshtë po ju paraqesë në formë tabelare edhe planin sipas Agjencionit të Barazisë Gjinore:

KOMUNA RAHOVEC

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit - rezultatet	Afati kohorë	Resurset-Burimet financiare
Vetëdijësim në çështjen e Barazisë Gjinore	Ligjerata - vetëdijësim nëpër shkolla të viseve rurale/urbane për barazi gjinore.	Z.B.GJ K. Rahovec	Përfitimi i njohurive në çështjen e barazisë gjinore nëpër vise rurale.	Janar - Prill	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.
Shënimi i ditës së 8 Marsit - ditës së gruas	Tryez e rrumbullakët/ marsh paqësor; aktivitete tjera.	Z.B.GJ Institucionet Komunale	Pjesëmarrja në debat, aktivitete	Mars	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.
Implementimi i rregullores për Barazi Gjinore	Implementimi i rregullores nga Institucionet e komunes	Z.B.GJ Institucionet Komunale	Implementimi dhe zbatimi i saj	Janar - Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.
Takime përgaditore me gratë e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioriteteve të grave me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjinore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të komunës	Mbajtja e ligjeratave debateve, tryezave për pjesëmarrjen e grave në hartimin e politikave dhe në planifikim të buxhetit; Seminar një ditor për drejtorët dhe komitetin për politik dhe financa; Hulumtim për vlerësim të përfshirjes së nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve (grave dhe burrave) në buxhetin e drejtorive të Komunës së Rahovecit.	Z.B.GJ Zyra e Kryetarit	Pjesëmarrja në hartim të planifikimit buxhetor	Janar Qershor Shtator	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.

KOMUNA RAHOVEC

Konferenca, seminare trajnime dhe tryeza te rumbullakta që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizm in në lidhje me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.	Vetëdijësimi në fushën e legjislacionit; Ligji për barazi gjinore; Ligji kundër diskriminimit; Ligji për familjen; Ligji mbi trashëgimin; Ligji kundër dhunës në familje si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me barazi gjinore.	ZKMZQM NJDNJ ABGJ Kuvendi komunal OJQ vendore dhe ndërkombëtare; Shoqëria civile	Përkrahja instucionale Transporti Buxheti	Janar Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë
Përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjinore, zbatimi, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre.	Identifikimi i mangësive të vendimeve të marra dhe legjislacioneve lidhur me të drejtat e njeriut krahasuar me standartet evropiane dhe ndërkombëtare.	ZKMZQM NJDNJ Kuvendi komunal, OJQ vendore dhe ndërkombëtare.	Rritja e nivelit të respektimit të drejtave të njeriut të qytetarëve, Legjislacioni vendor në përputhje me standartet evropiane dhe ndërkombëtare.	Janar Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë
Sensibilizimi, vetëdijësimi i gruas në përfaqësim-zgjedhje.	Ligjeratë, tryeza, për nxitjen e grave dhe rëndësinë e pjesëmarrjeve në zgjedhje – tema Vota e juaj përfaqësimi i juaj.	Kuvendi Komunal; Z.B.GJ; OJQ vendore dhe ndërkombëtare.	Rritja e nivelit të zbatimit të ligjeve të aplikuara të cilat flasin për barazi gjinore.	Korrik Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë
Fushat vetëdijësuse për kancerin e gjirit në kuadër të shënimit të ditës ndërkombëtare kundër	Ligjerata, shpërndarja e fletushkave informative, testi mamografis.	Z.B.GJ QKMF OJQ vendore	Vetëdijësimi i komunitetit nëpër vise rurale dhe urbane.	Tetor Nëntor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.

#### KOMUNA RAHOVEC

kancerit të gjirit.					
Takime me gra dhe burra rreth regjistrimit të pronës së palujtëshme në emër të të dy bashkëshortëve	Ligjerata dhe fletushka.	Z.B.GJ OJQ vendore dhe ndërkombëtare,	Vetëdijësimi i komunitetit nëpër vise rurale dhe urbane.	Gusht Tetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë.
Aktivitete kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore – 16 Ditët e Aktivizmit.	Ligjerata/aktivitete/ tryezë, me temën “16 ditë aktivizëm kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore”	Z.B.GJ Policia e Kosovës-Rahovec Mekanizmi Komunal kundër dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje.	Ligji për barazi gjinore; Ligji kundër dhunës në familje.	Nëntor Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë
Takime të rregullta me mekanizmin komunal kundër dhunës në familje	4 takime të rregullta brenda vitit, të Mekanizmit Komunal kundër dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje.	Z.B.GJ Anëtarët e mekanizmit Komunal	Ligji kundër dhunës në familje.	Janar-Dhjetor	Buxheti i kuvendit komunal dhe donator tjerë

**Alban Gashi**  
**Zyrtar për Barazi Gjinore**

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme